UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
REKTORATI

Pranuar me dt.	10.07.2026		
Njesia organ.	Numri	Nr Ekzem	Vlera
	1694		

UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË USHQIMORE

Pranuar me dt.	10. 07. 2026		
Njesia organ.	Numer	Nr Ekzempl.	Vlera
	199		

UNIVERSITETI / UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore

Këshilli i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, duke u bazuar në nenin 69 dhe 72 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, nenit 22 pika 1 të Rregullores mbi zgjedhjet në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë dhe punën e Këshillit të Fakultetit, nenit 8 të Rregullores nr. Prot. 1670, dt. 28.09.2021 për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë, si dhe Rregulloren nr. 2205, dt.26.09.2025, për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë më datë 10.07.2026 merr këtë:

PROPOZIM-VENDIM

I. Këshilli i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore në mbledhjen e mbajtur me datë 10.07.2026 ka shqyrtuar dhe aprovuar raportet e komisioneve vlerësuese, të emëruara nga Këshilli i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, sipas konkursit të shpallur, nr. Prot. 1493 të datës 17.06.2026 të UIBM-së, për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjerata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njësive akademike të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, për vitin akademik 2026-2027.

II. Në mbështetje të Rregullores me nr. Prot. 1670 të datës 28.09.2021 për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë dhe Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë, nr. Prot. 2205/1, dt. 26.09.2025, Këshilli i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, brenda afateve ligjore i propozon Senatit të UIBM-së, miratimin e propozimeve për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore, Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë.

III. **MIRATOHEN** Raportet e Komisioneve vlerësuese, për mësimdhënës dhe asistentë:

a) **Një mësimdhënës për lëndët**:"Matematika I" dhe "Matematika II", kandidat i suksesshëm **Dr.Sc.Elmi Shabani**
b) **Një asistent për lëndët:** "Bazat e informatikës" dhe "Softueri aplikativ në inxhinierinë mjedisore", kandidat i suksesshëm **MSc. Hasan Mlinaku**
c) **Një asistent për lëndët:** : "Kimia e përgjithshme", "Kimia fizike", "Kimia fizike I", "Kimia fizike II", "Teknologjia e përpunimit të pemëve dhe perimeve", "Teknologjia e përpunimit të qumështit", dhe "Metodologjia e punës kërkimore-shkencore", kandidat i suksesshëm **MSc. Albin Aliu.**
d) **Një asistent për lëndët:** "Kontrolli i cilësisë së produkteve ushqimore"Kimia Organike I", "Kimia Organike II", "Materialet me prejardhje shtazore", "Shkenca e ushqimit I", "Shkenca e ushqimit II", "Inxhinieria ushqimore", "Teknologjia e përpunimit të mishit dhe vezëve", "Analiza instrumentale e produkteve ushqimore", kandidat i suksesshëm **MSc. Eldina Latifi Haxhaj**.
e) **Një asistent për lëndët** "Kimia inorganike", "Kimia analitike", "Energjia dhe mjedisi", "Burimet alternative të energjisë", "Proceset e riqarkullimit", "Transporti i materieve të rrezikshme", kandidat i sukseshëm **MSc. Besijana Kurti.**

IV. **PROPOZIMI** për anulimin e procedurave të konkursit për pozicionet pa kandidatë:

POZITA II (Pika 1 dhe Pika 2): Propozohet anulimi i konkursit për angazhimin e një mësimdhënësi dhe një asistenti për lëndët „Gjuhë Gjermane I" dhe „Gjuhë Gjermane II", pasi në këtë pozicion nuk ka pasur asnjë kandidat të paraqitur (nuk ka aplikuar askush).

POZITA VI (Pika 1): Propozohet anulimi i konkursit të përbashkët (për njësitë akademike: FGJ, FTU, FEK dhe FJ) për pozicionin e një asistenti për lëndët „Gjuhë Angleze I" dhe „Gjuhë Angleze II", pasi nuk ka aplikuar asnjë kandidat.

Bashkëngjitur gjeni raportet e komisioneve vlerësuese.

I dorëzohet:

-Zyrës për çështje akademike

-Senatit të UIBM-së

-Arkivit të fakultetit

Kryesuesi i Këshillit të Fakultetit

Prof. dr. Mensur Kelmendi